REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 803/820/20
Datë/Datum. 13.11.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH.nr.803/20
820/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje të: Z. Nuhi Paçarizi - Kryetar, Z. Blerim Dina - Referues, Z. Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik "Studio Links 4"- Prishtinë dhe ankesës së OE N.N.SH. "Vizion Projekt" - Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë operatori ekonomik: N.P.T. "Arhing", lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Mbikqyrja e objektit të ri administrativ dhe objekteve përcjellëse të N.P. Termokos SH.A." me nr. të prokurimit: NPTermokos.sha-020-4865-2-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ N.P. Termokos SH.A., më datë: 02.11.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. **APROVOHEN**, pjesërisht si të bazuara ankesat e operatorit ekonomik "Studio Links 4"- Prishtinë dhe OE N.N.SH. "Vizion Projekt" - Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Mbikqyrja e objektit të ri administrativ dhe objekteve përcjellëse të N.P. Termokos SH.A." me nr. të prokurimit: NPTermokos.sha-020-4865-2-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ N.P. Termokos SH.A.

II. **ANULOHET,** njoftimi për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Mbikqyrja e objektit të ri administrativ dhe objekteve përcjellëse të N.P. Termokos SH.A." me nr. të prokurimit: NPTermokos.sha-020-4865-2-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ N.P. Termokos SH.A. dhe lënda kthehet në **Rivlerësim.**

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesat e operatorëve ekonomik ankues "Studio Links 4" – Prishtinë dhe OE N.N.SH. "Vizion Projekt" – Prishtinë, aprovohen pjesërisht si të bazuara, të njëjtëve iu bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohen operatorët ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Operatori ekonomik ankues "Studio Links 4" - Prishtinë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me datë: 12.10.2020 me nr. 803/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: ""Mbikqyrja e objektit të ri administrativ dhe objekteve përcjellëse të N.P. Termokos SH.A." me nr. të prokurimit: NPTermokos.sha-020-4865-2-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ N.P. Termokos SH.A., duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenet: 7, 69 dhe nenin 72 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Operatori ekonomik: N.N.SH. "Vizion Projekt" - Prishtinë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me dt: 19.10.2020 me nr. 820/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Mbikqyrja e objektit të ri administrativ dhe objekteve përcjellëse të N.P. Termokos SH.A." me nr. të prokurimit: NPTermokos.sha-020-4865-2-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ N.P. Termokos SH.A., duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 7, 59, 65 dhe nenin 69 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, si dhe nenin 41 të RrUOPP.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 20.10.2020, ka autorizuar ekspertin profesional të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti profesional i prokurimit në raportin e dt: 28.10.2020, lidhur me pretendimin ankimorë të OE-ankues sqaron si në vijim:

Përgjigje në pretendimet e operatorit ekonomik ankues "Studio Link 4" – Prishtinë

Lidhur me pretendimin e OE ankues, se AK ka bërë shkelje të nenit 7, 69 dhe 72 të LPP-së, duke u bazuar në faktet e hasura me rastin e trajtimit të lëndës, eksperti shqyrtues konstaton se pretendimi i lartcekur i OE ankues është i bazuar sepse OE i rekomanduar për kontratë së bashku me dosjen e tenderit ka bashkangjitur të gjitha kontratat e stafit të lidhura, respektivisht të nënshkruar mes punëtorëve dhe OE "N.P.T. ARHING" kinse në vitin 2006, 2007, 2008, 2009, 2010, 2014 dhe 2015, ndërsa në këto kontrata është paraqitur numri unik identifikues 810344995 i operatorit ekonomik "N.P.T. ARHING", ndërsa nga ATK është lëshuar njfotim zyrtar se nga data 11.02.2019 citoj: "Agjencia për Regjistrim të Bizneseve ka filluar me sistemin e ri të regjistrimit dhe pajisjes me Numër Unik Identifikues (NUI) të të gjitha shoqërive tregtare. Procesi i konsolidimit vullnetar dhe i pajisjes me NUI do të jetë në kohëzgjatje prej 6 muajve nga data e fillimit të sistemit të ri të regjistrimit" ky fakt mund të vërtetohet edhe përmes adresës/linkut:
http://ëëë.atk-ks.org/njoftim-per-tatimpagues-pajisjes-me-numer-unik-identifikues/.
Lidhur me pretendimin e OE ankuese se OE i rekomanduar "të gjitha CV-të e stafit janë në gjuhën angleze e cila nuk është gjuhë zyrtare", eksperti shqyrues sqaron se ky pretendim i OE ankues nuk është i bazuar sepse me paragrafin 4 te nenit 13 të LPP-së është lejuar që operatorët ekonomik të paraqesin dokumentet në njërën nga gjuhët shqipe, serbe ose angleze, për më tepër citoj paragrafin 4 te nenit 13 të LPP-së: "Një operator ekonomik mund të paraqesë një tender, një kërkesë për pjesëmarrje apo ndonjë dokument tjetër të kërkuar apo që lejohet të plotësohet gjatë aktivitetit të prokurimit, në gjuhën Shqipe, Serbe ose në gjuhën Angleze".
Shkelja 2: "OE ka ofruar stafin me emër Cenë Krasniqi si ekspert për efiqiencë dhe në kontratën e tij shkruan se i punësuari angazhohet me orar të plotë, ndërsa i njëjti është i punësuar si profesor i rregullt në UP dhe ligjërisht është e pamundur të jetë i punësuar në dy vende me orar të plotë."
Lidhur me pretendimin e lartëcekur të OE ankues, eksperti shqyrtues konstaton se qëndron fakti se OE i rekomanduar për kontratë ka bashkangjitur kontratën e punës për z. Cenë Krasniqi, në të cilën kontratë shkruan se "i punësuari themelon marrëdhënie pune me orar të plotë, orari i plotë gjatë ditës është 8 orë në ditë ndërsa 40 orë në javë". Poashtu, eksperti shqyrtues konstaton se ka hulumtuar dhe verifikuar përmes ëeb-faqes së Fakultetit të Ndërtimtarisë të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" respektivisht përmes linkut: https://fna.uni-pr.edu/Personeli/Personeli-akademik/Mr-sc--Cene-Krasniqi.aspx, dhe konstaton se z. Cenë Krasniqi është personel akademik në Fakultetin e Ndërtimtarisë në UP.
Shkelja 3:"Lidhur me inxhinierin e Gjeodezisë OE ka ofruar z. Rexhep Sopa i cili nuk është inxhinier sipas kërkesave të FDT por është BSC dhe i njëjti nuk i ka 10 vjet përvojë pune."
Duke u bazuar në faktet e hasura me rastin e trajtimit të lëndës, eksperti shqyrtues konstaton se pretendimi i lartëcekur i OE ankues është i bazuar sepse OE i rekomanduar për kontratë së bashku me dosjen e tenderit ka bashkangjitur për z. Rexhep Sopa, Diplomën e Baçelorit të Gjeodezisë të lëshuar nga Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës në UP me 11 prill 2012, kopjen e licencës së gjeodetit të lëshura nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor me 06.05.2020, CV, kopjen e kontratës dhe bazuar në këto dëshmi,

konstatohet se z. Rexhep Sopa nuk është inxhinier i gjeodezisë dhe nuk ka ofruar dëshmi se i njëjti ka 10 vite përvojë pune siç është kërkuar nga AK në njoftimin për kontratë dhe DT.

Shkelja 4: "Lidhur me ekspertin e licencuar dhe me certifikatë për mbrojtje kundër zjarrit, OE ka ofruar z. Shaban Halili i cili ka licensë e lëshuar nga Republika e Kosovës dhe diploma e ofruar tregon se është profesor i mbrojtjes. Të krahasohet licenca e ekspertit tonë të lëshuar nga MPB me licencën e ekspertit të OE", duke u bazuar në faktet e hasura me rastin e trajtimit të lëndës, eksperti shqyrtues konstaton se pretendimi i lartëcekur i OE ankues është i bazuar sepse OE i rekomanduar për kontratë së bashku me dosjen e tenderit ka bashkangjitur për z. Shaban Halili, Diplomen e Fakultetit të Mbrojtjes të Universitetit te Beogradit, të leshuar me 12 janar 1982, CV dhe kopjen e kontratës, mirëpo nuk ka ofruar ndonjë dëshmi respektivisht certifikatën për mbrojtje kundër zjarrit siç e ka kërkuar AK me njoftimin për kontratë dhe DT.

Shkelja 5: "Lidhur me ekspertin e licencuar dhe me certifikatë për ndikim në mjedis. OE ka dorëzuar vetëm një ekspert z. Adnan Bekteshi ndërsa eksperti tjetër i propozuar z. Shaqir Cana është inxhinier i ndërtimtarisë jo Ujësjellës. Inxhinier i ujësjellësit dhe kanalizimit, me pervojë 10 vjeçare (inxhinier i diplomuar dhe specialist i fushës) numri i stafit 2. OE nuk ka dorëzuar fare ekspertin në fjalë", duke u bazuar në faktet e hasura me rastin e trajtimit të lëndës, eksperti shqyrtues konstaton se pretendimi i lartëcekur i OE ankues është i bazuar sepse OE i rekomanduar për kontratë së bashku me dosjen e tenderit ka bashkangjitur për z. Adnan Bekteshi dhe z. Shaqir Cana, kopjet e kontratave të punës, kopje të diplomave të inxhinierit të ndërtimtarisë dhe CV-të, në të cilat është paraqitur përvoja e punës, mirëpo nuk është bashkangjitur asnjë dëshmi tjetër se të njëjtit kanë përvoje pune 10 vjeçare në fushën e ujësjellësit dhe kanalizimit si dhe OE i rekomanduar për kontratë nuk ka dorëzuar asnjë dëshmi dhe nuk ka përcaktuar asnjë punëtor për pozitën ekspert i licencuar dhe me certifikatë për ndikim në mjedis siç ka kërkuar AK me njoftimin për kontratë dhe DT.

Shkelja 6: "Lidhur me kapacitetin teknik dhe financiar: mungojnë transaksionet bankare me operatorët ekonomik privat. Kompania ka paraqitur referenca nga kompanitë private por me UOPP duhet që të paraqiten edhe transaksionet bankare", duke u bazuar në faktet e hasura me rastin e trajtimit të lëndës, eksperti shqyrtues konstaton se pretendimi i lartëcekur i OE ankues nuk është i bazuar sepse nuk ka qenë kerkesë e AK që në rast se OE refernca të kompanive private duhet të bashkangjiten edhe transaksionet bankare siç pretendon OE ankues, po ashtu pretendimi i OE ankuese është i paqartë sepse në një anë permend ke\ërkesat e kapacitetit teknik dhe financiar ndërsa pretendimin e lidhë me referencat e kompanive private që ndërlidhen me kerkesat e kapacitetit teknik dhe profesional, ndërsa eksperti shqyrtues konstaton se OE i rekomanduar për kontratë së bashku me dosjen e tenderit ka bashkëngjitur listën e projekteve të realizuara si dhe referencat sipas kërkesës së parashtruar nga AK me njoftimin për kontratë dhe DT.

Lidhur me pretendimet e OE ankues rreth arsyjes së eliminimit të potencuar nga AK me letrën standarde: "Lista e çmimeve e dorëzuar në ofertën tuaj ka gabime në llogaritjen të çmimit konkretisht tek të gjitha

pozicionet që është kërkuar çmimi total me TVSH ju keni përshkruar gabim çmimet dhe keni bërë gabim aritmetikor i evidentuar është më shumë se (2%) i vlerës totale të ofertës" se ky arsytim nuk qëndron sepse nuk ka ekzistuar lista e çmimeve por dokumenti i quajtur shërbime inxhinierike - propozim i metodës dhe analizës kritike lidhur me realizimin e projektit dhe në këtë propozim ka qenë tabela me pozicione ku OE është dashur të bëjë propozimin e tij në lidhje me qasjen e OE ndaj shërbimit inxhinierik, ne kemi bërë propozimet sipas skemës së kërkuar dhe këtu nuk ka asnjë gabim aritmetikor por vetëm fakte, nëse AK e ka pasur të paqartë propozimin tonë për ndarje në dy vite (ashtu siç kishte kërkuar vet AK në tabelë) atëherë ka qenë dashur të konsumoj nenin 72 të LPP-së".

Duke u bazuar në faktet e hasura me rastin e trajtimit të lëndës eksperti shqyrtues konstaton se pretendimi i lartëcekur i OE ankues është i bazuar sepse AK me rastin e eliminimit të OE ankues vetëm ka specifkuar "Lista e çmimeve e dorëzuar në ofertën tuaj ka gabime në llogaritjen e çmimit konkretisht tek të gjitha pozicionet që është kërkuar çmimi total me TVSH ju keni përshkruar gabim çmimet dhe keni bërë Gabimi(et) aritmetikor i evidentuar është më shumë se (2%) i vlerës totale të ofertës" ndërsa nuk ka ofruar ndonjë dëshmi të kalkulimit të çmimeve dhe gabimeve të gjetura. Poashtu, eksperti shqyrtues sqaron se konform tabelës së krijuar nga AK dhe sqarimeve të paraqitura nga OE ankues, ka kalkuluar ofertën financiare të dorëzuar nga OE në AK dhe konstaton se vlera totale e kësaj oferte është 74,906.40 €, i njëjti çmim figuron edhe në proceverbalin e hapjes së hartuar nga AK dhe mbi bazën e kësaj eksperti konstaton se oferta nuk ka asnjë gabim aritmetikor. Nëse AK e ka pasur të paqartë propozimin e OE ankues të ndarë në dy vite (ashtu siç kishte kërkuar vet AK në tabelë) atëherë ka qenë dashur që konform nenit 72 të LPP-së, të kërkoj sqarime para se të marrë vendim që ta eliminoj.

Lidhur me pretendimet e OE ankues, se AK ka bërë shkelje të nenit 69 të LPP-së, duke u bazuar në faktet e gjetura me rastin e trajtimit të lëndës, eksperti shqyrtues konstaton se pretendimet e operatorit ekonomik ankues nuk është i bazuar sepse OE ankues pretendimet në fjalë vetëm i ka cekur sipërfaqësisht pa sqaruar dhe pa dhënë ndonjë fakt rreth shkeljes së këtyre neneve në deklaratën e ankesës së dorëzuar, po ashtu me nenin 69 të LPP-së rregullohen respektivisht udhëzohen Autoritetet Kontraktuese se si mund të kërkojnë dhe vendosin në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë kërkesat minimale si dhe cilat dëshmi duhet të kërkohen-dorëzohen nga OE lidhur me aftësitë teknike dhe/ose profesionale, gjatë ushtrimit/zhvillimit të një aktiviteti të prokurimit.

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues N.N.SH. "Vizion Projekt" – Prishtinë

Lidhur me pretendimin e OE ankues, se AK ka bërë shkelje të nenit 1, 7 dhe 59 të LPP-së si dhe në kundërshtim me nenin 41.3 të RrUOPP, duke u bazuar në faktet e hasura me rastin e trajtimit të lëndes eksperti shqyrtues konstaton se pretendimi i lartëcekur i OE ankues është i bazuar sepse OE i rekomanduar për kontratë, nuk ka dorëzuar asnjë dëshmi dhe nuk ka përcaktuar asnjë punëtor për pozitën ekspert i licencuar dhe me certifikatë për ndikim në mjedis siç ka kërkuar AK me njoftimin për kontratë dhe DT.

Lidhur me pretendimin e OE ankuese se- OE i rekomanduar për kontratë nuk ka plotësuar kërkesën për 1 inxhinier i gjeodezisë, për arsye se z. Rexhë Sopa nuk është inxhinier i gjeodezisë ashtu siç është kërkuar në DT, por është Bachelor i Gjeodezisë, duke u bazuar në faktet e hasura me rastin e trajtimit të lëndës eksperti shqyrtues konstaton se pretendimi i lartë cekur i OE ankues është i bazuar sepse OE i rekomanduar për kontratë së bashku me dosjen e tenderit ka bashkangjitur për z. Rexhep Sopa, diplomën e Baçelorit të Gjeodezisë të lëshuar nga Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës në UP me 11 prill 2012, kopjen e licencës së gjeodetit të lëshuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor me 06.05.2020, CV, kopjen e kontratës dhe bazuar në këto dëshmi konstatohet se z.Rexhep Sopa nuk është inxhinier i gjeodezisë dhe nuk ka ofruar dëshmi se i njëjti ka 10 vite përvojë pune siç është kërkuar nga AK në njoftimin për kontratë dhe DT.

Lidhur me pretendimin e OE ankuese se - 1 arkiteikt të prezetuar nga OE i rekomanduar për kontratë (Rrezarta Aliderna Kukaj) i mungon Dëshmia për përvojën e punës 10 vjecare nga Trusti Pensional dhe dëshmi tjera (i mungojnë referenca që do të mund të dëshmonin përvojën 10 vjecare të punës).

Duke u bazuar në faktet e hasura me rastin e trajtimit të lëndës eksperti shqyrtues konstaton se pretendimi i lartcekur i OE ankues është i bazuar sepse OE i rekomanduar për kontratë së bashku me dosjen e tenderit ka bashkangjitur për znj. Rrezarta Aliderna Kukaj, diplomën e inxhinier i diplomuar i arkitekturës, CV dhe kopjen e kontratës, mirëpo nuk ka dorëzuar asnjë dëshmi për t'a vërtetuar se e njëjta ka 10 vite përvojë pune siç është kërkuar nga AK në njoftimin për kontratë dhe DT.

Lidhur me pretendimin e OE ankues se – 1 inxhinieri të ndërtimtarisë të prezetuar nga OE i rekomanduar për kontratë (Jeton Canhasi) i mungon Dëshmia për përvojën e punës 10 vjecare nga Trusti pensional ose dëshmi tjera (i mungojnë referenca që do të mund të dëshmonin përvojën 10 vjeçare të punës), duke u bazuar në faktet e hasura me rastin e trajtimit të lëndës eksperti shqyrtues konstaton se pretendimi i lartcekur i OE ankues është i bazuar sepse OE i rekomanduar për kontratë së bashku me dosjen e tenderit ka bashkangjitur për z. Jeton Canhasi, Diplomën e inxhinierit të diplomuar të ndërtimtarisë dhe CV, i njëjti sipas certifikatës së biznesit shihet se është pronarë i OE N.P.T. ARHING, mirëpo nuk është dorëzuar asnjë deshmi për t'a vërtetuar se i njëjti ka 10 vite përvojë pune siç është kërkuar nga AK në njoftimin për kontratë dhe DT.

Lidhur me pretendimin e OE ankues se - 1 inxhinieri të elektroteknikës të prezetuar nga OE i rekomanduar për kontratë (Besim Gojani) i mungon Dëshmia për përvojën e punës 10 vjecare nga Trusti Pensional ose dëshmi tjera (i mungojnë referenca që do të mund të dëshmonin përvojën 10 vjeçare të punës), duke u bazuar në faktet e hasura me rastin e trajtimit të lëndës eksperti shqyrtues konstaton se pretendimi i lartcekur i OE ankues është pjesërisht i bazuar sepse OE i rekomanduar për kontratë së bashku me dosjen e tenderit ka bashkangjitur për z. Jeton Canhasi, diplomën e inxhinierit të diplomuar të ndërtimtarisë dhe CV, i njëjti sipas certifikatës se biznesit shihet se është pronarë i OE N.P.T. ARHING, mirëpo nuk është dorëzuar asnjë dëshmi

për t'a vërtetuar se i njëjti ka 10 vite përvojë pune siç është kërkuar nga AK në njoftimin për kontratë dhe DT.

Lidhur me pretendimin e OE ankues se -1 inxhinieri të makinerisë të prezetuar nga OE i rekomanduar për kontratë (Qani Nuhiu) i mungon diploma origjinal ose e noterizuar, duke u bazuar në faktet e hasura me rastin e trajtimit të lëndës eksperti shqyrtues konstaton se pretendimi i lartcekur i OE ankues është i bazuar sepse OE i rekomanduar për kontratë së bashku me dosjen e tenderit ka bashkangjitur për z. Qani Nuhiu, kopjen e diplomës se inxhinierit të diplomuar të makinerisë, mirëpo nuk e njëjta nuk është e noterizuar, siç është kërkuar nga AK në njoftimin për kontratë dhe DT.

Lidhur me pretendimin e OE ankues se -1 inxhinieri të makinerisë të prezetuar nga OE i rekomanduar për kontratë (Bujar Komoni) i mungon d Dëshmia për përvojën e punës 10 vjecare nga Trusti Pensional ose dëshmi tjera (i mungojnë referenca që do të mund të dëshmonin përvojën 10 vjeçare të punës), duke u bazuar në faktet e hasura me rastin e trajtimit të lëndës eksperti shqyrtues konstaton se pretendimi i lartcekur i OE ankues ankues është i bazuar sepse OE i rekomanduar për kontratë së bashku me dosjen e tenderit ka bashkangjitur për z. Bujar Komani, diplomën e inxhinierit të diplomuar të makinerisë, CV dhe kopjen e kontratës, mirëpo nuk është dorëzuar asnjë dëshmi për t's vërtetuar se i njejti ka 10 vite përvojë pune siç është kërkuar nga AK në njoftimin për kontratë dhe DT.

Lidhur me pretendimin e OE ankues se - 1 inxhinieri të ujësjellësit dhe të kanalizimit të prezetuar nga OE i rekomanduar për kontratë (Shaqir Cana) i mungon diploma origjinal ose e noterizuar i mungon dëshmia për përvojën e punës 10 vjeçare nga Trusti pensional ose dëshmi tjera (i mungojnë referenca që do të mund të dëshmonin përvojën 10 vjeçare të punës), duke u bazuar në faktet e hasura me rastin e trajtimit të lëndës eksperti shqyrtues konstaton se pretendimi i lartcekur i OE ankues është i bazuar sepse OE i rekomanduar për kontratë së bashku me dosjen e tenderit ka bashkangjitur për z. Shaqir Cana, kopjen e diplomës së inxhinierit të diplomuar të ndërtimtarisë, CV dhe kopjen e kontratës, mirëpo kopja e diplomës nuk nuk është e noterizuar si dhe nuk është dorëzuar asnjë dëshmi për t'a vërtetuar se i njëjti ka 10 vite përvojë pune siç është kërkuar nga AK në njoftimin për kontratë dhe DT.

Lidhur me pretendimin e OE ankues se -1 inxhinieri të ujësjellësit dhe të kanalizimit të prezetuar nga OE i rekomanduar Për kontratë (Adnan Bekteshi) i mungon dëshmia për përvojën e punës 10 vjeçare nga Trusti pensional ose dëshmi tjera (i mungojnë referenca që do të mund të dëshmonin përvojën 10 vjeçare të punës), duke u bazuar në faktet e hasura me rastin e trajtimit të lëndës eksperti shqyrtues konstaton se pretendimi i lartcekur i OE ankues është i bazuar sepse OE i rekomanduar për kontratë së bashku me dosjen e tenderit ka bashkangjitur për z. Adnan Bekteshi, kopjen e diplomës së inxhinierit të diplomuar të ndërtimtarisë, CV dhe kopjen e kontratës, mirëpo nuk është dorëzuar asnjë dëshmi për t'a vërtetuar se i njëjti ka 10 vite përvojë pune siç është kërkuar nga AK në njoftimin për kontratë dhe DT.

Lidhur me pretendimin e OE ankues se -1 inxhinieri të energjisë së efiqiencës të prezetuar nga OE i rekomanduar per kontratë (Cenë Krasniqi) i mungon diploma origjinal ose e noterizuar, i mungon dëshmia për përvojën e punës 5 vjeçare nga Trusti pensional ose dëshmi tjera (i mungojnë referenca që do të mund të dëshmonin përvojën 5 vjeçare të punës), duke u bazuar në faktet e hasura me rastin e trajtimit të lëndës eksperti shqyrtues konstaton se pretendimi i lartcekur i OE është i bazuar sepse OE i rekomanduar për kontratë së bashku me dosjen e tenderit ka bashkangjitur për z. Cenë Krasniqi, kopjen e certifikatës se trajnimit, CV dhe kopjen e kontratës, mirëpo I mungon diploma apo kopja e diplomës e noterizuar si dhe nuk është dorëzuar asnjë dëshmi për t'a vërtetuar se i njëjti ka 5 vite përvojë pune siç është kërkuar nga AK në njoftimin për kontratë dhe DT.

Lidhur me pretendimin e OE ankuese se -1 eksperti të licencuar me certifikatë për mbrojtje kundër zjarrit të prezetuar nga OE i rekomanduar për kontratë (Shaban Halili) i mungon dëshmia për përvojën e punës 10 vjeçare nga Trusti pensional ose dëshmi tjera (i mungojnë referenca që do të mund të dëshmonin përvojën 5 vjeçare të punës), duke u bazuar në faktet e hasura me rastin e trajtimit të lëndës eksperti shqyrtues konstaton se pretendimi i lartcekur i OE ankues është i bazuar sepse OE i rekomanduar për kontratë së bashku me dosjen e tenderit ka bashkangjitur për z. Shaban Haliti, kopjen e diplomës të vërtetuar tek noteri, CV dhe kopjen e kontratës, mirëpo nuk është dorëzuar asnjë deshmi për t'a vërtetuar se i njëjti ka 5 vite përvoj pune siç është kërkuar nga AK në njoftimin për kontratë dhe DT.

Lidhur me pretendimin e OE ankues se -1 eksperti të sigurisë dhe të kualitetit në punë të prezetuar nga OE i rekomanduar për kontratë (Liridon Mavraj) i mungon mungon diploma ose certifikata origjinal ose e noterizuar; dëshmia për përvojën e punës nga Trusti pensional ose dëshmi tjera (i mungojnë referenca që do të mund të dëshmonin përvojën e punës), duke u bazuar në faktet e hasura me rastin e trajtimit të lëndës eksperti shqyrtues konstaton se pretendimi i lartcekur i OE ankues është i bazuar sepse OE i rekomanduar për kontratë së bashku me dosjen e tenderit ka bashkangjitur për z. Liridon Mavraj, kopjen e certifikatës per çështje të sigurisë dhe shëndetit në punë të lëshuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, CV dhe kopjen e kontratës, mirëpo i mungon diploma apo kopja e diplomës e noterizuar si dhe nuk është dorëzuar asnjë dëshmi për t'a vërtetuar se i njëjti ka përvojë pune siç është kërkuar nga AK në njoftimin për kontratë dhe DT.

Lidhur me pretendimet e OE ankues, se AK ka bërë shkelje të nenit 65 dhe 69 të LPP-së, duke u bazuar në faktet e gjetura me rastin e trajtimit të lëndës, eksperti shqyrtues konstaton se pretendimet e operatorit ekonomik ankues nuk janë të bazuara sepse OE ankuese pretendimet në fjalë vetëm i ka cekur sipërfaqësisht pa sqaruar dhe pa dhënë ndonjë fakt rreth shkeljes së këtyre neneve në deklaratën e ankesës së dorëzuar, po ashtu me nenin 65 dhe 69 të LPP-së rregullohen respektivisht udhëzohen autoritetet kontraktuese se në cilat raste nuk mund të bëhet pranushmeria e kandidatëve, respektivisht i ndalohet tenderusve që të marrin pjesë në një aktivitet të prokurimit si dhe udhëzohen autoritetet kontraktuese se si mund të kërkojnë dhe vendosin

në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë kërkesat minimale si dhe cilat dëshmi duhet të kërkohen-dorëzohen nga OE lidhur me aftësitë teknike dhe/ose profesionale, gjatë ushtrimit/zhvillimit të një aktiviteti të prokurimit.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesat e OE ankues "Studio Links 4" - Prishtinë dhe ankesa e OE ankues "N.N.SH. Vizion Projekt" – Prishtinë, të aprovohen si pjesërisht te bazuara, të anulohet vendimi i AK-së për dhënien e kontratës si dhe rekomandon që lënda të kthehet në Rivlerësim.

Autoriteti Kontraktues më datë 29.10.2020, me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në se pajtohet pjesërisht me mendimin e ekspertit shqyrtues, duke shtuar:
Pajtohemi pjeserisht me mendimin e ekspertit shqyrtues, vetëm në pretendimin numër 6 të parshtruar nga OE N.N.SH. "Studio Links 4" nuk pajtohemi mendimin e ekspertit shqyrtues, ndërsa me pretendimet tjera pajtohemi me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik N.N.SH. "Vizion Projekt" - Prishtinë më datë: 29.10.2020, me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik "Studio Links 4" - Prishtinë më datë 29.10.2020, me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 12.11.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit profesional të prokurimit dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Lidhur me pretendimin e OE ankues "Studio Link 4" – Prishtinë, se AK ka bërë shkelje të nenit 7, 69 dhe 72 të LPP-së, Paneli Shqyrtues konform ekspertit profesional konstaton se pretendimi i lartcekur i OE ankues është i bazuar sepse OE i rekomanduar për kontratë së bashku me dosjen e tenderit ka bashkangjitur të gjitha kontratat e stafit të lidhura, respektivisht të nënshkruara mes punëtorëve dhe OE "N.P.T. ARHING" kinse në vitin 2006, 2007, 2008, 2009, 2010, 2014 dhe 2015, ndërsa në këto kontrata është paraqitur numri unik identifikues 810344995 i operatorit ekonomik "N.P.T. ARHING", ndërsa nga ATK është lëshuar njoftim

zyrtar se nga data 11.02.2019, ku thuhet: "Agjencia për Regjistrim të Bizneseve ka filluar me sistemin e ri të regjistrimit dhe pajisjes me Numër Unik Identifikues (NUI) të të gjitha shoqërive tregtare. Procesi i konsolidimit vullnetar dhe i pajisjes me NUI do të jetë në kohëzgjatje prej 6 muajve nga data e fillimit të sistemit të ri të regjistrimit" ky fakt mund të vërtetohet edhe përmes adresës/linkut: http://ëëë.atk-ks.org/njoftim-per-tatimpagues-pajisjes-me-numer-unik-identifikues/.

Lidhur me pretendimin e OE ankues "Studio Link 4" – Prishtinë, se OE i rekomanduar "të gjitha CV-të e stafit janë në gjuhën angleze e cila nuk është gjuhë zyrtare", Paneli Shqyrtues konform ekspertit profesional sqaron se ky pretendim i OE ankues nuk është i bazuar sepse me paragrafin 4 të nenit 13 të LPP-së është lejuar që operatorët ekonomik të paraqesin dokumentet në njërën nga gjuhët shqipe, serbe ose angleze, ku në paragrafin 4 të nenit 13 të LPP-së thuhet: "Një operator ekonomik mund të paraqesë një tender, një kërkesë për pjesëmarrje apo ndonjë dokument tjetër të kërkuar apo që lejohet të plotësohet gjatë aktivitetit të prokurimit, në gjuhën Shqipe, Serbe ose në gjuhën Angleze".

Sa i përket pretendimit tjetër të OE ankues "Studio Link 4" – Prishtinë , se OE ka ofruar stafin me emër Cenë Krasniqi si ekspert për efiqiencë dhe në kontratën e tij shkruan se i punësuari angazhohet me orar të plotë, ndërsa i njëjti është i punësuar si profesor i rregullt në UP dhe ligjërisht është e pamundur të jetë i punësuar në dy vende me orar të plotë."

Paneli Shqyrtues konform ekspertit profesional sqaron se qëndron fakti se OE i rekomanduar për kontratë ka bashkangjitur kontratën e punës për z. Cenë Krasniqi, në të cilën kontratë shkruan se "i punësuari themelon marrëdhënie pune me orar të plotë, orari i plotë gjatë ditës është 8 orë në ditë ndërsa 40 orë në javë". Po ashtu, Paneli Shqyrtues sqaron se eksperti profesional ka hulumtuar dhe verifikuar përmes ëeb-faqes së Fakultetit të Ndërtimtarisë të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", respektivisht përmes linkut: https://fna.uni-pr.edu/Personeli/Personeli-akademik/Mr-sc--Cene-Krasniqi.aspx, dhe konstaton se z. Cenë Krasniqi është personel akademik në Fakultetin e Ndërtimtarisë në UP.

Në lidhje me pretendimin e OE ankues "Studio Link 4" – Prishtinë, se inxhinier të Gjeodezisë OE ka ofruar z. Rexhep Sopa i cili nuk është inxhinier sipas kërkesave të FDT por është BSC dhe i njëjti nuk i ka 10 vjet përvojë pune."

Paneli Shqyrtues konform ekspertit profesional sqaron se ky pretendim është i bazuar sepse OE i rekomanduar për kontratë së bashku me dosjen e tenderit ka bashkangjitur për z. Rexhep Sopa Diplomën e Baçelorit të Gjeodezisë, të lëshuar nga Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës në UP me 11 prill 2012, kopjen e licencës së gjeodetit të lëshuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor me 06.05.2020, CV, kopjen e kontratës dhe bazuar në këto dëshmi, konstatohet se z. Rexhep Sopa nuk është inxhinier i

gjeodezisë dhe nuk ka ofruar dëshmi se i njëjti ka 10 vite përvojë pune siç është kërkuar nga AK në njoftimin për kontratë dhe dosje të tenderit.

Lidhur me pretendimin e OE ankues "Studio Link 4" – Prishtinë, që ka të bëjë me ekspertin e licencuar dhe me certifikatë për mbrojtje kundër zjarrit, ku OE ka ofruar z. Shaban Halili i cili ka licencë të lëshuar nga Republika e Kosovës dhe diploma e ofruar tregon se është profesor i mbrojtjes. Të krahasohet licenca e ekspertit tonë të lëshuar nga MPB me licencën e ekspertit të OE".
Paneli Shqyrtues konform ekspertit profesional të prokurimit sqaron se pretendimi i OE ankues është i bazuar sepse OE i rekomanduar për kontratë së bashku me dosjen e tenderit ka bashkangjitur për z. Shaban Halili, Diplomen e Fakultetit të Mbrojtjes të Universitetit te Beogradit, të lëshuar me 12 janar 1982, CV dhe kopjen e kontratës, mirëpo nuk ka ofruar ndonjë dëshmi, respektivisht certifikatën për mbrojtje kundër zjarrit siç e ka kërkuar AK me njoftimin për kontratë dhe dosje të tenderit.

Pretendimi tjetër i OE ankues "Studio Link 4" – Prishtinë, që ka të bëjë me ekspertin e licencuar dhe me certifikatë për ndikim në mjedis, ku OE ka dorëzuar vetëm një ekspert z. Adnan Bekteshi ndërsa eksperti tjetër i propozuar z. Shaqir Cana është inxhinier i ndërtimtarisë jo Ujësjellës. Inxhinier i ujësjellësit dhe kanalizimit, me pervojë 10 vjeçare (inxhinier i diplomuar dhe specialist i fushës) numri i stafit 2. OE nuk ka dorëzuar fare ekspertin në fjalë".
Paneli Shqyrtues konform ekspertit profesional sqaron se pretendimi i lartcekur i OE ankues është i bazuar sepse OE i rekomanduar për kontratë së bashku me dosjen e tenderit ka bashkangjitur për z. Adnan Bekteshi dhe z. Shaqir Cana, kopjet e kontratave të punës, kopje të diplomave të inxhinierit të ndërtimtarisë dhe CV-të, në të cilat është paraqitur përvoja e punës, mirëpo nuk është bashkangjitur asnjë dëshmi tjetër se të njëjtit kanë përvoje pune 10 vjeçare në fushën e ujësjellësit dhe kanalizimit, si dhe OE i rekomanduar për kontratë nuk ka dorëzuar asnjë dëshmi dhe nuk ka përcaktuar asnjë punëtor për pozitën ekspert i licencuar dhe me certifikatë për ndikim në mjedis siç ka kërkuar AK me njoftimin për kontratë dhe dosje të tenderit.

Në lidhje me pretendimin tjetër të OE ankues "Studio Link 4" – Prishtinë, që ka të bëjë me kapacitetin teknik dhe financiar: mungojnë transaksionet bankare me operatorët ekonomik privat. Kompania ka paraqitur referenca nga kompanitë private por me UOPP duhet që të paraqiten edhe transaksionet bankare".
Paneli Shqyrtues konform ekspertit profesional sqaron se pretendimi i OE ankues nuk është i bazuar sepse nuk ka qenë kërkesë e AK që në rast se OE dorëzojnë refernca të kompanive private duhet të bashkëngjiten edhe transaksionet bankare, siç pretendon OE ankues, po ashtu pretendimi i OE ankuese është i paqartë sepse në një anë përmend kërkesat e kapacitetit teknik dhe financiar ndërsa pretendimin e lidhë me referencat e kompanive private që ndërlidhen me kërkesat e kapacitetit teknik dhe profesional. Pra, Paneli Shqyrtues

konform eksperti profesional konstaton se OE i rekomanduar për kontratë së bashku me dosjen e tenderit ka bashkëngjitur listën e projekteve të realizuara si dhe referencat sipas kërkesës së parashtruar nga AK me njoftimin për kontratë dhe dosje të tenderit.

Lidhur me pretendimet e OE ankues "Studio Link 4" – Prishtinë, rreth arsyeve të eliminimit të potencuar nga AK me letrën standarde: "Lista e çmimeve e dorëzuar në ofertën tuaj ka gabime në llogaritjen të çmimit konkretisht tek të gjitha pozicionet që është kërkuar çmimi total me TVSH ju keni përshkruar gabim çmimet dhe keni bërë gabim aritmetikor i evidentuar është më shumë se (2%) i vlerës totale të ofertës" se ky arsyetim nuk qëndron sepse nuk ka ekzistuar lista e çmimeve por dokumenti i quajtur shërbime inxhinierike - propozim i metodës dhe analizës kritike lidhur me realizimin e projektit dhe në këtë propozim ka qenë tabela me pozicione ku OE është dashur të bëjë propozimin e tij në lidhje me qasjen e OE ndaj shërbimit inxhinierik, ne kemi bërë propozimet sipas skemës së kërkuar dhe këtu nuk ka asnjë gabim aritmetikor por vetëm fakte, nëse AK e ka pasur të paqartë propozimin tonë për ndarje në dy vite (ashtu siç kishte kërkuar vet AK në tabelë) atëherë ka qenë dashur të konsumoj nenin 72 të LPP-së".
Paneli Shqyrtues konform ekspertit profesional sqaron se pretendimi i lartcekur i OE ankues është i bazuar sepse AK me rastin e eliminimit të OE ankues vetëm ka specifkuar "Lista e çmimeve e dorëzuar në ofertën tuaj ka gabime në llogaritjen e çmimit konkretisht tek të gjitha pozicionet që është kërkuar çmimi total me TVSH ju keni përshkruar gabim çmimet dhe keni bërë Gabimi(et) aritmetikor i evidentuar është më shumë se (2%) i vlerës totale të ofertës", ndërsa nuk ka ofruar ndonjë dëshmi të kalkulimit të çmimeve dhe gabimeve të gjetura. Po ashtu, Paneli Shqyrtues konform ekspertit profesional sqaron se konform tabelës së krijuar nga AK dhe sqarimeve të paraqitura nga OE ankues, ka kalkuluar ofertën financiare të dorëzuar nga OE në AK dhe konstaton se vlera totale e kësaj oferte është 74,906.40 €, i njëjti çmim figuron edhe në proceverbalin e hapjes së hartuar nga AK dhe mbi bazën e kësaj, Paneli Shqyrtues konform ekspertit konstaton se oferta nuk ka asnjë gabim aritmetikor. Nëse AK e ka pasur të paqartë propozimin e OE ankues të ndarë në dy vite (ashtu siç kishte kërkuar vet AK në tabelë) atëherë ka qenë dashur që konform nenit 72 të LPP-së, të kërkoj sqarime para se të marrë vendim që ta eliminoj.

Sa i përket pretendimit të fundit të OE ankues "Studio Link 4" – Prishtinë, se AK ka bërë shkelje të nenit 69 të LPP-së, Paneli Shqyrtues konform ekspertit profesional sqaron se pretendimi i operatorit ekonomik ankues nuk është i bazuar sepse OE ankues pretendimet në fjalë vetëm i ka cekur sipërfaqësisht pa sqaruar dhe pa dhënë ndonjë fakt rreth shkeljes së këtyre neneve në deklaratën e ankesës së dorëzuar. Po ashtu, me nenin 69 të LPP-së rregullohen respektivisht udhëzohen Autoritetet Kontraktuese se si mund të kërkojnë dhe vendosin në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë kërkesat minimale si dhe cilat dëshmi duhet të kërkohen-

dorëzohen nga OE lidhur me aftësitë teknike dhe/ose profesionale, gjatë ushtrimit/zhvillimit të një aktiviteti të prokurimit.

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues N.N.SH. "Vizion Projekt" – Prishtinë
Lidhur me pretendimin e OE ankues N.N.SH. "Vizion Projekt" – Prishtinë, se AK ka bërë shkelje të nenit 1, 7 dhe 59 të LPP-së si dhe në kundërshtim me nenin 41.3 të RrUOPP.
Paneli Shqyrtues konform ekspertit prfoesional sqaron se pretendimi i OE ankues është i bazuar sepse OE i rekomanduar për kontratë nuk ka dorëzuar asnjë dëshmi dhe nuk ka përcaktuar asnjë punëtor për pozitën ekspert i licencuar dhe me certifikatë për ndikim në mjedis siç ka kërkuar AK me njoftimin për kontratë dhe dosje të tenderit.

Në lidhje me pretendimin e OE ankues N.N.SH. "Vizion Projekt" – Prishtinë, se OE i rekomanduar për kontratë nuk ka plotësuar kërkesën për 1 inxhinier i gjeodezisë, për arsye se z. Rexhë Sopa nuk është inxhinier i gjeodezisë ashtu siç është kërkuar në dosje të tenderit por është Bachelor i Gjeodezisë. Paneli Shqyrtues konform ekspertit profesional sqaron se pretendimi i lartë cekur i OE ankues është i bazuar sepse OE i rekomanduar për kontratë së bashku me dosjen e tenderit ka bashkangjitur për z. Rexhep Sopa, diplomën e Baçelorit të Gjeodezisë të lëshuar nga Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës në UP me 11 prill 2012, kopjen e licencës së gjeodetit të lëshuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor me 06.05.2020, CV, kopjen e kontratës dhe bazuar në këto dëshmi konstatohet se z.Rexhep Sopa nuk është inxhinier i gjeodezisë dhe nuk ka ofruar dëshmi se i njëjti ka 10 vite përvojë pune siç është kërkuar nga AK në njoftimin për kontratë dhe dosje të tenderit.

Sa i përket pretendimit tjetër të OE ankues N.N.SH. "Vizion Projekt" – Prishtinë, se arkitektit të prezantuar nga OE i rekomanduar për kontratë (Rrezarta Aliderna Kukaj) i mungon Dëshmia për përvojën e punës 10 vjeçare nga Trusti Pensional dhe dëshmi tjera (i mungojnë referenca që do të mund të dëshmonin përvojën 10 vjeçare të punës).
Paneli Shqyrtues konform ekspertit profesional të prokurimit sqaron se pretendimi i OE ankues është i bazuar sepse OE i rekomanduar për kontratë së bashku me dosjen e tenderit ka bashkangjitur për znj. Rrezarta Aliderna Kukaj, diplomën e inxhinier i diplomuar i arkitekturës, CV dhe kopjen e kontratës, mirëpo nuk ka dorëzuar asnjë dëshmi për t'a vërtetuar se e njëjta ka 10 vite përvojë pune siç është kërkuar nga AK në njoftimin për kontratë dhe dosje të tenderit.

Pretendimi tjetër i OE ankues N.N.SH. "Vizion Projekt" – Prishtinë, se inxhinierit të ndërtimtarisë të prezantuar nga OE i rekomanduar për kontratë (Jeton Canhasi) i mungon Dëshmia për përvojën e punës 10

vjeçare nga Trusti pensional ose dëshmi tjera (i mungojnë referenca që do të mund të dëshmonin përvojën 10 vjeçare të punës).

Paneli Shqyrtues konform ekspertit profesional sqaron se pretendimi i OE ankues është i bazuar sepse OE i rekomanduar për kontratë së bashku me dosjen e tenderit ka bashkangjitur për z. Jeton Canhasi, Diplomën e inxhinierit të diplomuar të ndërtimtarisë dhe CV, i njëjti sipas certifikatës së biznesit shihet se është pronar i OE N.P.T. ARHING, mirëpo nuk është dorëzuar asnjë dëshmi për t'a vërtetuar se i njëjti ka 10 vite përvojë pune siç është kërkuar nga AK në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit.

Në lidhje me pretendimin e OE ankues N.N.SH. "Vizion Projekt" – Prishtinë, se inxhinierit të elektroteknikës të prezantuar nga OE i rekomanduar për kontratë (Besim Gojani) i mungon Dëshmia për përvojën e punës 10 vjecare nga Trusti Pensional ose dëshmi tjera (i mungojnë referenca që do të mund të dëshmonin përvojën 10 vjeçare të punës).

Paneli Shqyrtues konform ekspertit profesional sqaron se ky pretendim i OE ankues është pjesërisht i bazuar sepse OE i rekomanduar për kontratë së bashku me dosjen e tenderit ka bashkangjitur për z. Jeton Canhasi, diplomën e inxhinierit të diplomuar të ndërtimtarisë dhe CV, i njëjti sipas certifikatës se biznesit shihet se është pronar i OE N.P.T. ARHING, mirëpo nuk është dorëzuar asnjë dëshmi për t'a vërtetuar se i njëjti ka 10 vite përvojë pune siç është kërkuar nga AK në njoftimin për kontratë dhe dosje të tenderit.

Sa i përket pretendimit të OE ankues N.N.SH. "Vizion Projekt" – Prishtinë, se inxhinierit të makinerisë të prezantuar nga OE i rekomanduar për kontratë (Qani Nuhiu) i mungon diploma origjinal ose e noterizuar.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit profesional të prokurimit sqaron se ky pretendim i OE ankues është i bazuar sepse OE i rekomanduar për kontratë së bashku me dosjen e tenderit ka bashkangjitur për z. Qani Nuhiu, kopjen e diplomës se inxhinierit të diplomuar të makinerisë, mirëpo nuk e njëjta nuk është e noterizuar, siç është kërkuar nga AK në njoftimin për kontratë dhe dosje të tenderit.

Lidhur me pretendimin e OE ankues N.N.SH. "Vizion Projekt" – Prishtinë, se inxhinierit të makinerisë të prezantuar nga OE i rekomanduar për kontratë (Bujar Komoni) i mungon dëshmia për përvojën e punës 10 vjeçare nga Trusti Pensional ose dëshmi tjera (i mungojnë referenca që do të mund të dëshmonin përvojën 10 vjeçare të punës).

Paneli Shqyrtues konform ekspertit profesional sqaron se ky pretendim i OE ankues është i bazuar sepse OE i rekomanduar për kontratë së bashku me dosjen e tenderit ka bashkangjitur për z. Bujar Komani, diplomën e inxhinierit të diplomuar të makinerisë, CV dhe kopjen e kontratës, mirëpo nuk është dorëzuar asnjë dëshmi për t'a vërtetuar se i njëjti ka 10 vite përvojë pune siç është kërkuar nga AK në njoftimin për kontratë dhe dosje të tenderit.

Lidhur me pretendimin e OE ankues N.N.SH. "Vizion Projekt" – Prishtinë, se inxhinierit të ujësjellësit dhe të kanalizimit të prezantuar nga OE i rekomanduar për kontratë (Shaqir Cana) i mungon diploma origjinal ose e noterizuar i mungon dëshmia për përvojën e punës 10 vjeçare nga Trusti pensional ose dëshmi tjera (i mungojnë referenca që do të mund të dëshmonin përvojën 10 vjeçare të punës).
Paneli Shqyrtues konform ekspertit profesional sqaron se ky pretendim i OE ankues është i bazuar sepse OE i rekomanduar për kontratë së bashku me dosjen e tenderit ka bashkangjitur për z. Shaqir Cana, kopjen e diplomës së inxhinierit të diplomuar të ndërtimtarisë, CV dhe kopjen e kontratës, mirëpo kopja e diplomës nuk është e noterizuar si dhe nuk është dorëzuar asnjë dëshmi për t'a vërtetuar se i njëjti ka 10 vite përvojë pune siç është kërkuar nga AK në njoftimin për kontratë dhe dosje të tenderit.

Në lidhje me pretendimin e OE ankues N.N.SH. "Vizion Projekt" – Prishtinë, se inxhinieri të ujësjellësit dhe të kanalizimit të prezantuar nga OE i rekomanduar për kontratë (Adnan Bekteshi) i mungon dëshmia për përvojën e punës 10 vjeçare nga Trusti pensional ose dëshmi tjera (i mungojnë referenca që do të mund të dëshmonin përvojën 10 vjeçare të punës).
Paneli Shqyrtues konform ekspertit profesional sqaron se ky pretendim i OE ankues është i bazuar sepse OE i rekomanduar për kontratë së bashku me dosjen e tenderit ka bashkangjitur për z. Adnan Bekteshi, kopjen e diplomës së inxhinierit të diplomuar të ndërtimtarisë, CV dhe kopjen e kontratës, mirëpo nuk është dorëzuar asnjë dëshmi për t'a vërtetuar se i njëjti ka 10 vite përvojë pune siç është kërkuar nga AK në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit.

Kurse, sa i përket pretendimit të OE ankues N.N.SH. "Vizion Projekt" – Prishtinë, se inxhinierit të energjisë së efiqiencës të prezantuar nga OE i rekomanduar për kontratë (Cenë Krasniqi) i mungon diploma origjinal ose e noterizuar, i mungon dëshmia për përvojën e punës 5 vjeçare nga Trusti pensional ose dëshmi tjera (i mungojnë referenca që do të mund të dëshmonin përvojën 5 vjeçare të punës).
Paneli Shqyrtues konform ekspertit profesional sqaron se ky pretendim i OE është i bazuar sepse OE i rekomanduar për kontratë së bashku me dosjen e tenderit ka bashkangjitur për z. Cenë Krasniqi, kopjen e certifikatës se trajnimit, CV dhe kopjen e kontratës, mirëpo I mungon diploma apo kopja e diplomës e noterizuar si dhe nuk është dorëzuar asnjë dëshmi për t'a vërtetuar se i njëjti ka 5 vite përvojë pune siç është kërkuar nga AK në njoftimin për kontratë dhe dosje të tenderit.

Pretendimit tjetër i OE ankues N.N.SH. "Vizion Projekt" – Prishtinë, se ekspertit të licencuar me certifikatë për mbrojtje kundër zjarrit të prezantuar nga OE i rekomanduar për kontratë (Shaban Halili) i mungon

dëshmia për përvojën e punës 10 vjeçare nga Trusti pensional ose dëshmi tjera (i mungojnë referenca që do të mund të dëshmonin përvojën 5 vjeçare të punës).
Paneli Shqyrtues konform ekspertit profesional të prokurimit sqaron se ky pretendim i OE ankues është i bazuar sepse OE i rekomanduar për kontratë së bashku me dosjen e tenderit ka bashkangjitur për z. Shaban Haliti, kopjen e diplomës të vërtetuar tek noteri, CV dhe kopjen e kontratës, mirëpo nuk është dorëzuar asnjë deshmi për t'a vërtetuar se i njëjti ka 5 vite përvojë pune siç është kërkuar nga AK në njoftimin për kontratë dhe dosje të tenderit.

Në lidhje me pretendimin tjetër të OE ankues N.N.SH. "Vizion Projekt" – Prishtinë, se ekspertit të sigurisë dhe të kualitetit në punë të prezantuar nga OE i rekomanduar për kontratë (Liridon Mavraj) i mungon diploma ose certifikata origjinal ose e noterizuar; dëshmia për përvojën e punës nga Trusti pensional ose dëshmi tjera (i mungojnë referenca që do të mund të dëshmonin përvojën e punës).
Paneli Shqyrtues konform ekspertit profesional sqaron se ky pretendim i OE ankues është i bazuar sepse OE i rekomanduar për kontratë së bashku me dosjen e tenderit ka bashkangjitur për z. Liridon Mavraj, kopjen e certifikatës për çështje të sigurisë dhe shëndetit në punë të lëshuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, CV dhe kopjen e kontratës, mirëpo i mungon diploma apo kopja e diplomës e noterizuar si dhe nuk është dorëzuar asnjë dëshmi për t'a vërtetuar se i njëjti ka përvojë pune siç është kërkuar nga AK në njoftimin për kontratë dhe dosje të tenderit.

Lidhur me pretendimet e OE ankues N.N.SH. "Vizion Projekt" – Prishtinë, se AK ka bërë shkelje të nenit 65 dhe 69 të LPP-së, Paneli Shqyrtues konform ekspertit profesional të prokurimit sqaron se pretendimet e operatorit ekonomik ankues nuk janë të bazuara sepse OE ankues pretendimet në fjalë vetëm i ka cekur sipërfaqësisht pa sqaruar dhe pa dhënë ndonjë fakt rreth shkeljes së këtyre neneve në deklaratën e ankesës së dorëzuar. Po ashtu, me nenin 65 dhe 69 të LPP-së rregullohen respektivisht udhëzohen autoritetet kontraktuese se në cilat raste nuk mund të bëhet pranueshmëria e kandidatëve, respektivisht i ndalohet tenderuesve që të marrin pjesë në një aktivitet të prokurimit si dhe udhëzohen autoritetet kontraktuese se si mund të kërkojnë dhe vendosin në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë kërkesat minimale si dhe cilat dëshmi duhet të kërkohen-dorëzohen nga OE lidhur me aftësitë teknike dhe/ose profesionale, gjatë ushtrimit/zhvillimit të një aktiviteti të prokurimit.

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, pretendimeve ankimorë të operatorëve ekonomik ankues dhe sqarimeve të ekspertit profesional, vjen në përfundim se autoriteti kontraktues nuk e ka bërë ekzaminimin dhe krahasimin e tenderëve në bazë të kërkesave të dosjes së tenderit dhe në harmoni me nenin 59 të LPP-së. Andaj, obligohet AK që të kërkoj sqarime shtesë konform nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së, si dhe të

bëjë ekzamnimin, krahasimin dhe vlerësimin e tenderëve në bazë të kërkesave të dosjes së tenderit dhe në harmoni me nenin 59 të LPP-së.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Nuhi PAÇARIZI

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK-Termokos sh.a;

1x1 OE "Studio Links 4" – Prishtinë;

1x1 OE N.N.SH. "Vizion Projekt" – Prishtinë;

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.